



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*MINISTRIA E FINANCAVE/MINISTARSTVO ZA FINANSIJE*  
*MINISTRY OF FINANCE*

KB FR Kosovo Board on Standards for Financial Reporting  
 BK RF Bordi Kosovar mbi Standardet per Raportim Financiar  
 KB FI Kosovski Bord za Standarde Finansijskog Izvestavanja

## **SKK 9**

### **Kostoja e huamarrjes**

#### **Qëllimi**

Qëllimi i këtij standardi është që ta përcaktojë procedurën kontabile për koston e huamarrjes. Standari e kërkon shndërrimin e menjëhershëm të koston së huazimit në shpenzim. Kapitalizimi i koston së huazimit nuk lejohet gjatë përvetësimit ose ndërtimit të një pasurie.

#### **Fushëveprimi**

1. Ky standard duhet të zbatohet në kontabilitetin e koston së huamarrjes.
2. Ky standard nuk ka të bëjë me koston aktuale apo të ngarkuar të kryegjësë.

#### **Përkufizimet**

3. Termet në vijim të përdorura në këtë standard i kanë këto kuptime specifike:

**Kostot e huazimit** janë interesi apo kostot e tjera të krijuara nga një ndërmarrje në lidhje me huazimin financiar.

4. Kostoja e huazimit mund të përfshijë:
  - (a) interesin për hua afatgjata dhe afatshkurtëra

- (b) amortizimin e zbritjeve dhe të premive që kanë të bëjnë me hua.
- (c) tarifat financiare që krijohen nga qiratë financiare të pranuar në përputhje me SKK 13 "Lizingjet"

### **Pranimi i kostos së huazimit**

- 5. Kostoja e huazimit duhet të pranohet si një shpenzim gjatë periudhës, kur ajo është krijuar.

### **Shpalosja**

- 6. Kostoja financiare duhet të shpaloset si një zë në pasqyrën e të hyrave në përputhje me SKK1 "Paraqitja e pasqyrave financiare". Nënklasifikimet e tjera duhet të shpalosen në shënime, nëse një paraqitje e tillë është e domosdoshme për ta paraqitur rezultatin financiar fer të ndërmarrjes.

### **Data e hyrjes në fuqi**

Ky standard do të hyjë në fuqi për raporte financiare që u përkasin periudhave prej 1 janar 2002 apo më tutje. Do të rekomandohet zbatimi i mëhershëm i këtij standardi.